

UDHËZIM
Nr. 17, datë 20.7.2022

PËR LEJEN E QARKULLIMIT TË MJETEVE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE TË TYRE¹

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 4, të nenit 92 dhe nenit 224, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

Neni 1

Udhëzimi zbatohet për lejen e qarkullimit të lëshuar në momentin e regjistrimit të mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre.

Neni 2

Për qëllimin e këtij udhëzimi:

- a) “mjet” kuptohet çdo mjet rrugor që klasifikohet sipas nenit 47, pika 1, germat “P” deri në “I”, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) “regjistrim” kuptohet autorizimi administrativ për hyrjen në shërbimin e qarkullimit rrugor të një mjeti, që përfshin identifikimin e këtij të fundit dhe lëshimin për të, të një numri serial (targë), i cili njihet si numri i regjistrimit;
- c) “leje qarkullimi” kuptohet dokumenti i cili vërteton se mjeti është regjistruar në Shqipëri;
- d) “mbajtës i lejes së qarkullimit” kuptohet personi ose subjekti në emër të të cilit një mjet është i regjistruar;
- e) “pezullim” kupton një periudhë të kufizuar kohore në të cilën një mjet nuk është i autorizuar të përdoret në qarkullim rrugor, pas së cilës, me kusht që arsyet e pezullimit kanë pushuar së vepruari, të mund të autorizohet të përdoret përsëri, pa u përfshirë në një proces të ri regjistrimi;
- f) “heqja e mjetit nga qarkullimi” kuptohet anulimi i autorizimit që një mjet të përdoret në qarkullimin rrugor;
- g) “modeli i lejes së qarkullimit” kuptohet modeli i lejes së qarkullimit i miratuar me urdhrin nr. 284, datë 7.10.2020, “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjeteve rrugore”, të ministrit përgjegjës për transportin.

Neni 3

1. Degët përkatëse të Drejtorisë Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) lëshojnë leje qarkullimi për mjetet rrugore, të cilat janë subjekt regjistrimi, sipas legjislacionit në fuqi. Leja e qarkullimit është sipas modelit të miratuar me urdhrin nr. 284, datë 7.10.2020, “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjeteve rrugore”, të ministrit përgjegjës për transportin.

2. Kur lëshohet një leje qarkullimi e re, për një mjet të regjistruar përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, DPSHTRR-ja të përdorë modelin e lejes së qarkullimit të miratuar me urdhrin nr. 284, datë 7.10.2020, “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjeteve rrugore”, të ministrit përgjegjës për transportin, dhe mund t’i kufizojë të dhënat e plotësuar në lejen e qarkullimit, me ato të cilat janë të disponueshme.

¹ Udhëzimi synon përputhshmëri të plotë me direktivën nr. Celex 01999L0037-20180520, 1999/EU të Këshillit Evropian e 20 prillit 1999, “Mbi dokumentet e regjistrimit të mjeteve rrugore”.

3. Të dhënat që jepen në lejen e qarkullimit, të miratuar me urdhrin nr. 284, datë 7.10.2020, “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjeteve rrugore”, të ministrit përgjegjës për transportin, janë sipas kodeve të harmonizuara të BE-së.

4. DPSHTRR-ja mban në mënyrë elektronike të dhënat për të gjitha mjetet rrugore të regjistruara në Republikën e Shqipërisë. Këto të dhëna përfshijnë:

a) të gjitha elementet e detyrueshme, që përfaqësojnë kodet [A], [B], [C], [D], [E], [F], [J], [G], [I], [K], [P], [Q], [S], [V.7] dhe [V.9] në lejen e qarkullimit, të miratuar me urdhrin nr. 284, datë 7.10.2020, “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjeteve rrugore”, të ministrit përgjegjës për transportin, kur të dhënat janë të disponueshme;

b) të dhëna të tjera jo të detyrueshme të listuara në modelin e lejes së qarkullimit ose të dhëna të certifikatës së konformitetit të mjetit, kur është e mundur;

c) datën e vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik, kur është e mundur.

5. Përpunimi i të dhënave personale në kontekstin e këtij udhëzimi duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Të dhënat teknike të mjetit të jenë në dispozicion të qendrave të kontrollit teknik, me qëllim të kontrollit teknik të mjeteve.

7. Përdorimi i të dhënave nga qendrat e kontrollit teknik duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Kur DPSHTRR-ja merr njoftimin nga organet ligjzbatuese për pezullimin e lejes qarkullimit, për shkak të moskryerjes së kontrollit teknik, pezullimi regjistrohet në mënyrë elektronike. Regjistrimi i pezullimit anulohet kur lëshohet certifikata e kryerjes së kontrollit teknik. Kur një mjet i regjistruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian është hequr në mënyrë të përhershme nga qarkullimi, shërbimi i regjistrimit të këtij mjeti nga DPSHTRR do të refuzohet.

Neni 5

Me qëllim regjistrimin e një mjeti të regjistruar më parë në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, DPSHTRR-ja kërkon, në çdo rast, paraqitjen e lejes së qarkullimit të mëparshëm. Në rast se leja e qarkullimit të mëparshëm është me pjesë, kërkohet pjesa I e lejes së qarkullimit, si dhe paraqitja e pjesës II, nëse ajo është lëshuar. DPSHTRR-ja tërheq pjesën/t e lejes së qarkullimit të mëparshëm të paraqitur dhe e mban këtë të fundit për një minimum prej gjashtë muajsh. DPSHTRR-ja duhet që, brenda dy muajve, të informojë autoritetin e Shtetit Anëtar të Bashkimit Evropian, i cili ka lëshuar lejen e qarkullimit, për tërheqjen e saj. DPSHTRR-ja i kthen autoritetit kompetent të shtetit anëtar, lejen e qarkullimit të tërhequr, nëse autoriteti i shtetit anëtar e kërkon atë brenda gjashtë muajve nga tërheqja e saj.

Kur leja e qarkullimit përbëhet nga pjesa I dhe II, dhe pjesa II mungon, DPSHTRR-ja mund të vendosë, në raste të veçanta, mbi regjistrimin e mjetit, por vetëm pasi ka marrë konfirmim me shkrim ose me mjete elektronike nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të Bashkimit Evropian, ku mjeti ishte regjistruar më parë, se kërkuesi ka të drejtë të regjistrojë mjetin në një shtet tjetër.

Neni 6

Ministria përgjegjëse për transportin bën përditësimet e këtij udhëzimi, sipas akteve të miratuara nga Komisioni Evropian, i autorizuar sipas direktivës përkatëse të miratuar nga akte të deleguara.

Neni 7

DPSHTRR-ja, shkëmben informacione në nivel dypalësh ose shumëpalësh, në mënyrë që të kontrollojë, para regjistrimit të një mjeti, statusin ligjor të tij kur nevojitet, në shtetin në të cilën mjeti ishte i regjistruar më parë.

Një kontroll i tillë mund të përfshijë, veçanërisht për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit, përdorimin e rrjetit elektronik, që përmban të dhëna nga databazat e të dhënave elektronike të shteteve përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku